



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

th ë r r e t

mbledhjen e **nëntë** të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **13.12.2024** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. "UÇK", nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së tetë dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për kompensim vjetor financiar të punonjësve të administratës së Komunës së Prishtinës;
3. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Rregullores për kompensim ditor për financimin e ushqimit për punonjësit e Komunës së Prishtinës;
4. Propozim-vendimi për subvencionimin e KRM "Pastrimi", SHA;
5. Diskutim lidhur me kërkesat e banorëve të fshatit Shkabaj;
6. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2024 (TM3);
7. Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026;
8. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;

9. Propozim-vendimi për formimin e komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e Aktvendimit mbi eksproprijim, nr. 07, nr. 465-25/85, të datës 8 korrik 1985;
10. Informatë për fillimin e vitit shkollor 2024-2025 në Kryeqytet;
11. Raporti vjetor i punës për vitin 2023, lidhur me punën e Komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike "Termokos", SHA;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-165437/24, më 16.12.2024

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

